

VENDIM
Nr. 44, datë 12.4.2016

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “PHOENIX PETROLEUM” SHA NË
AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË
GAZIT NATYROR**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 4, pikat 50, 105, 107; neni 22, pika 2, germa “ç”; neni 83, pika 2, e ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe neneve 4, pika 1, germa “ç”; neni 8, neni 9, pika 1, pika 2, germa “e” dhe nenit 10, pika 11, të rregullores “Për procedurat e licencimit, ndryshimit, transferimit të plotë/të pjesshëm, heqjen dhe rinovimin e licencave në sektorin e gazit natyror”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 9, datë 11.2.2011, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 12.4.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Phoenix Petroleum” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për licencimin në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Phoenix Petroleum” sh.a., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, ndryshimit, transferimit të plotë/të pjesshëm, heqjen dhe rinovimin e licencave në sektorin e gazit natyror”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni ligjor, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 1 germa “d”/“i”, “d”/“ii”, “d”/“iv”, “d”/“v”, “d”/“vi”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni dhe garancitë financiare dhe fiskale (neni 9, pika 1, germa “e”/“i”, “e”/“ii”, “e”/“iii”, “e”/“v”, “e”/“vi”) janë plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni specifik për llojin e licencës (neni 9, pika 2, germa “e”/“i”, “e”/“ii”, “e”/“iii”).

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë “Phoenix Petroleum” sh.a., në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror për një periudhë 10-vjeçare (dhjetëvjeçare).

2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

ANËTARE E BORDIT TË KOMISIONERËVE
Entela Shehaj